



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry
of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV
Për vlerësimin e pasurisë së MASHT-it

NUMËR: 15/2010
DATË:15.10.2010

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 43.3,c të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

1. Përmes këtij Udhëzimi administrativ krijohet një sistem koherent në:

- 1.1.** Sigurimin e menaxhimit efektiv të pasurive të MASHT-it;
- 1.2.** Mbajtjen e saktë të dhënave mbi pasuritë e MASHT-it.

Neni 2
Fushëveprimi

Me këtë Udhëzim administrativ rregullohen procedurat e vlerësimit të pasurisë për përdorim nga MASHT.

Neni 3
Themelimi i komisionit

=Zyrtari kryesor administrativ i MASHT-it duhet të themelojë Komisionin për vlerësim

të pasurisë në përputhje me nenin 4 të këtij udhëzimi.

Neni 4

Komisioni për inventarizimin e pasurive

1. Komisioni për vlerësimin e pasurive do të jetë organ i formuar aty për aty nga MASHT-it.
2. Komisionin për vlerësimin e pasurive e cakton zyrtari kryesor administrativ.
3. Komisioni do të jetë si vijon:
 - 3.1. Të ketë jo më pak se tre anëtarë;
 - 3.2. Të përbëhet nga anëtarët që punojnë në MASHT.
4. Përgjegjësitë e komisionit për vlerësimin e pasurive janë si në vijim:
 - 4.1. Vlerësimi i pasurive që nuk kanë vlere te bartur;
 - 4.2. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;
 - 4.3. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;
 - 4.4. Duhet të prezantojë dëshmi për vlerësimin e pasurive.
5. Aktivitetet që i paraprijnë vlerësimit:
 - 5.1. Vendimi për vlerësimin e pasurive;
 - 5.2. Emërtimi i komisionit për vlerësim.

Neni 5

Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.


Enver Hoxhaj, ministër